



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës:	2021:106861
Datë:	13.10.2022
Numri i dokumentit:	03523952

PN.S.nr.45/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - DEPARTAMENTI SPECIAL, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Afërdita Bytyçi – kryetare e kolegjit, Vaton Durguti dhe Ferit Osmani – anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bajram Rexhahmetaj, në çështjen penale ndaj të pandehurve F.M., DH.H., G.D., për shkak të veprës penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par 2 të KPRK-së dhe E.T. për shkak të veprës penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par. 2 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesave të mbrojtësve të të akuzuarve F.M., avokat Arbër Jashari, DH.H., avokat Florent Latifaj, G.D., avokate Kosovare Kelmendi dhe E.T., avokat Driton Muharremi, të ushtruara kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Departamenti Special në Prishtinë PS.nr.20/22 të datës 27.07.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 02.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve F.M., avokat Arbër Jashari, DH.H., avokat Florent Latifaj, G.D., avokate Kosovare Kelmendi dhe E.T., avokat Driton Muharremi, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore -Departamenti Special në Prishtinë, PS.nr.20/22 të datës 27.07.2022, **VERTËTOHET**.

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës në Prishtinë ka ushtruar aktakuzën PPS.nr.63/2022 të dt.12.05.2022 kundër të pandehurve F.M., DH.H., G.D. për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par 2 të KPRK-së dhe E.T. për shkak të veprës penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par. 2 lidhur me nenin 33 të KPRK-së.

Gjykata Themelore Departamenti Special në Prishtinë, me aktvendimin PS.nr.20/22 të datës 27.07.2022, ka refuzuar kërkesat për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, të ushtruara nga mbrojtësit e të akuzuarve F.M., DH.H., G.D. dhe E.T. av. Arbër Jashari, av. Florent Latifaj, av. Kosovare Kelmendi dhe av. Driton Muharremi të gjithë nga Prishtina të angazhuar me autorizim.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë:

- Mbrojtësi i të pandehurit F.M., avokat Arbër Jashari, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, aplikimit të gabuar të dispozitave materiale dhe konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike , me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta ndryshoj aktvendimin dhe të pranohet kërkesa për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave dhe të pushoj procedurën penale.
- Mbrojtësi i të pandehurës DH.H., avokat Florent Latifaj, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën, ta kthej çështjen në rivendosje ose ta hudhë poshtë aktakuzën dhe të pushohet procedura penale
- Mbrojtësja e të pandehurit G.D., avokate Kosovare Kelmendi, nuk i ka specifikuar shkaqet ankimore të parapara sipas KPP, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktakuza të hudhet si e pa bazuar.

- Mbrojtësi i të pandehurit E.T., avokat Driton Muharremi, për shkak të shkeljes esenciale të procedurës penale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes të dispozitave materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën, të hudhet aktakuze ose të anulohet aktvendimi në rivendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën, PPN/I.nr.323/22, të dt.31.08.2022, ka propozuar që të refuzohen si të pa bazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve dhe aktvendimin i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore në ankesa, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Mbrojtësi i të pandehurit F.M., avokat Arbër Jashari, pretendon se në aktvendimin e ankimuar nuk paraqiten arsyet mbi faktet kryesore dhe nuk trajtohen argumentet e paraqitura në kërkesën për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave. Mbrojtja i kundërshton pretendimet e cekur në aktakuzë sa i përkitë të pandehurit dhe potencon se nuk është vërtetuar dashje për të kryer veprën penale dhe se prokuroria nuk ka paraqitur asnjë provë .po ashtu nuk mundë të vërtetohet se i pandehur ka pasur lidhje me operatorin fitues. Po ashtu mbrojtja e konteston edhe ekspertizën financiare si dhe kërkon që të shpallët prove e pa pranueshme deklarata e dëshmitares B.V. pasi që është marrë me presion, andaj mbrojtja propozon si më lartë.

Në ankesën e mbrojtësit të pandehurës DH.H., avokat Florent Latifaj, pretendon se aktakuza nuk përmbushë detyrimin e nivelit për tu dërguar në shqyrtim gjyqësorë pasi mungojnë elementet esenciale të cilat kërkohen me rastin e kryerjes së kësaj veprë penale. Janë të paqëndrueshme pretendime e prokurorisë se e pandehura ka keqpërdoruar projektet e IPA për promovim politik. Po ashtu nuk janë sqaruar se si me veprimet e të pandehurës janë konsumuar elementet e veprës penale, prandaj nuk ka asnjë provë se dëshmon se është kryer vepra penale dhe se nuk ka asnjë përfitim nga ana e të pandehurës, andaj mbrojtja propozon si më lartë.

Në ankesën e mbrojtësit të pandehurit G.D., avokate Kosovare Kelmendi, konsideron se në lidhje me të pandehurin në pikën III të aktakuzës nga përshkrimi faktike i aktakuzës provat që janë propozuar nuk korrespondojnë ndaj të pandehurit. Po ashtu nga ana e të pandehurit janë respektuar detyrat e tija zyrtare me perpikëmeri, dhe se në cilësinë e menaxherit të kontratës as

nuk ka pasur kompetence dhe as nuk i ka caktuar anëtarët e komisionit. Mbrojtja ceke se në aktvendimin e ankimuar nuk janë dhënë arsye për të gjitha propozimet dhe të njëjta nuk janë vendosur, andaj mbrojtësja propozon si më lartë.

Në ankesën e mbrojtësit të pandehurit E.T., avokat Driton Muharremi, pretendon se nuk janë arsyetuar fare pretendimet e mbrojtjes. Në aktvendimin e ankimuar ceken disa deklaratat të dëshmitarëve e të cilët nuk kanë të bëjë fare me të pandehurin e po ashtu edhe ekspertizat nuk e inkriminojnë të pandehurin. Po ashtu cekte se i pandehuri nuk e ka cilësinë e personit zyrtar dhe i njëjti është hyre në marrëdhënie kontraktuale me Ministrinë e Integritetit Evropian. Mbrojtja kundërshton në tërësi aktakuzën e cila ndaj të pandehurit nuk i plotëson kushtet për dyshimin e bazuar mirë dhe me këtë nuk ka as provë që e mbështet këtë dyshim duke përfshirë ekspertizat, deklaratat e dëshmitarëve, andaj mbrojtja propozon si më lartë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara, sepse me aktvendimin për refuzimin e kërkesës për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, gjykata e shkallës së parë në aktvendimin e ankimuar i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë kërkesat e paraqitura nga mbrojtësit dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme se aktakuza e ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, dëshmohet se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilën akuzohen duke u mbështetur në prova materiale, andaj nga vlerësimi i shkresave të lëndës për në këtë fazë të procedurës nuk ka asnjë rrethanë që mund të plotëson kushtet për kundërshtimin e provave nga neni 249 par.1 të KPPRK-së, si dhe kushtet për hedhjen e aktakuzës nga neni 250 par. 1 të KPPK-së.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate në aktvendimin e kundërshtuar, Gjykata e shkallës së parë ka dhënë në mënyrë të zgjeruar arsye lidhur me dyshimin e bazuar rreth provave të kundërshtuara dhe drejt ka vërtetuar se ekzistojnë prova të mjaftueshme të pranueshme në aspektin ligjor-procedural, duke u bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se nga veprimet e përshkruara në aktakuzë, tani ekzistojnë elementet qenësore të veprave penale për të cilën janë akuzuar të akuzuarit, prandaj në këtë drejtim pretendimet ankimore janë të pa bazuara.

Pretendimet e mbrojtësve të pandehurve në lidhje me provat të cilat janë paraqitur në këtë aktakuzë, janë të pabazuara, sepse Gjykata e Apelit, e gjen se në parim provat ndaj të pandehurve janë marrë në mënyrë të ligjshme ndërsa për besueshmërinë dhe vlerësimin e provave i takon

Gjykatës së shkallës së parë që t'i vlerësoj provat në raport me të gjithë të akuzuarit dhe të vendos lidhur me administrimin e tyre në procedurën e mëtejshme gjyqësore. Pretendimet tjera të mbrojtësve kryesisht kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, çka kjo Gjykatë gjen se në këtë fazë të procedurës nuk mund të vlerësohen provat, por të njëjtat duhet të administrohen në shqyrtim të hapur gjyqësor.

Për arsyet e lartcekura, kjo Gjykatë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur ka refuzuar kërkesat e mbrojtëseve të të akuzuarve për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, si të pabazuara në bazë të nenit 249 par.3 të KPPRK-së, me që nuk paraqitet asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 250 par.1 nënpar.1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitës së nenit 416 par.2 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti Special

PN.S.nr.45/22, datë 02.09.2022

Bashkëpunëtori profesional

Kryetare e kolegjit

Bajram Rexhahmetaj

Afërdita Bytyçi